



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva
i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture Development Agency

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë , mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, për “Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”, dhe Rregullores nr. 02/2010, “Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil”, me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit shpall:

KONKURS (i Brendshëm)

Titulli i pozitës: Drejtor i Drejtorisë për Autorizimin e Pagesave

Ref: RN00002993

Njësia Organizative: Drejtoria e Autorizimit të Pagesave - AZHB

Vendi i punës: Prishtinë

Kategoria funksionale: Niveli drejtues

Koeficienti: 10

Qëllimi i vendit të punës:

Drejtori i Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave organizon, menaxhon dhe kordinon punën e drejtorisë, merr pjesë në procesin e përgatitjes së dokumentacionit lidhur me zbatimin e programit IPARD dhe të skemave nacionale. Rishikon dhe nenshkruan autorizimet e pagesave dhe cdo dokument që del nga drejtoria. Të gjitha detyrat duhet të kryhen në përputhje me aktet ligjore nacionale në fuqi dhe legjislacionit europian.

Detyrat kryesore:

1. Udheheqë dhe cakton objektivat e drejtorise në përputhje me strategjine dhe objektivat e AZHB-se dhe dizajnon planet vjetore të punës të detajuara për ti përmbushur këto objektiva: 20%
2. Menaxhon stafin dhe buxhetin e drejtorisë dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit ; 20%
3. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë; 10%
4. Zhvillon dhe mbikëqyrë zbatimin e drejtë të akteve ligjore dhe akteve tjera si dhe bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse dhe divizionet tjera brenda AZHB-së: 15%
5. Mbikëqyrë kontrollin administrative të kërkesave për pagesë dhe mbikëqyrjen e vlerësimit të raporteve të kontrollit të dytë për projektet IPA dhe nacionale. 10%
6. Mbikëqyr kalkulimin e pagesave pas raporteve të kontrollit të dytë nga terreni për investimet e realizuara sipas faturave , qarkullimit bankar dhe çmimoreve të AZHB-së 10%
7. Përgatitja e listave për ekzekutimin e pagesave 10%
8. Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrjen dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimit, seminareve për kryerjen e detyrave në përputhje me standartet e kërkuara 5%

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

Njohuri paraprake ne fushën e autorizimit te pagesave;

Diploma Universitare: **Shkenca të Bujqësi, Ekonomisë, ose Relevante;**

Përvoja në punë: 6 vite përvojë pune profesionale - 3 vite përvoj në vende udheheqese;

Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve(Ëord, Excel, Power Point,Access)

Fleksibilitet dhe aftësi për t'u përballë me situata të reja;

Shkathtësi ne menaxhim, organizim, caktim te objektivave dhe planifikim;

Njohja e gjuhës angleze e preferuar.

Data e shpalljes së konkursit me: 06.04.2018

Data e mbylljes së konkursit me: 13.04.2018

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë - M B P Z H R , Ndërtesa e Bankës së Lublanës Kati i VII , Zyra nr. 16 ose të shkarkohen në adresën e internetit të AZHB-së www.azhb-ks.net.